

## Vendim nr. 261 datë 08.11.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Genti Ibrahimimi,	Anëtar
Sonila Bejtja,	Anëtare

në datën 08.11.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 9 (I) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

**KËRKUES:** ILIR SOPOTI

**OBJEKTI:** Shfuqizimi i vendimeve nr. 2488 akti, datë 14.06.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 2136, datë 10.10.2018 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2024-748, datë 23.04.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 31, 33, 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sonila Bejtja, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

**I**

**Rrethanat e çështjes**

1. Kërkuesi Ilir Sopoti është pronar i një shtëpie, të ndodhur në Tiranë, e cila është shpallur monument kulture prej vitit 1973 dhe, si e tillë, është e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Inventarizimit të Pasurive Kulturore. Në datën 12.05.2009 shtetasi I.Ç. ka filluar të kryejë punime në objektin e tij, i ndodhur ngjitur me banesën e kërkuesit. Punimet konsistojnë në shembje çatie, rrëzim muresh të brendshme dhe një gropë rreth 2 metër larg nga themeli i banesës së kërkuesit.

2. Kërkuesi, duke pretenduar se nga punimet rrezikohet prona e tij, i është drejtuar Bashkisë Tiranë dhe Institutit të Monumenteve të Kulturës për marrjen e informacionit nëse punimet po kryheshin me leje ndërtimi, të cilat i kanë kthyer përgjigje se nuk ishte dhënë asnjë leje për kryerjen e punimeve. Gjithashtu, sipas kërkuesit, ai i ka kërkuar Agjencisë së Legalizimit Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale (ALUIZNI) që të mos legalizonte punimet pa leje, por institucioni i ka injoruar kërkesat e tij dhe ka dhënë lejen e legalizimit nr. 6741, datë 27.05.2011 në favor të shtetasit I.Ç. Kërkuesi ka pretenduar se leja e legalizimit është dhënë në kundërshtim me ligjin, duke u shpërdoruar detyra nga nëpunësit shtetërorë. Në këtë situatë, kërkuesi ka paraqitur kallëzim penal ndaj shtetasit I.Ç. dhe punonjësës E.P., si dhe punonjësve të tjerë të ALUIZNI-it në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (*prokuroria*), e cila ka regjistruar procedimin penal nr. 4171/2011.

3. Prokuroria, në funksion të procedimit, ka sekuestruar praktikën e legalizimit të ndërtimit të shtetasit I.Ç., dokumentet shkresore nga institucione të ndryshme, si dhe ka marrë deklaratime nga persona që kanë pasur dijeni për rrethanat. Nga hetimet ka rezultuar se në emër të shtetasit I.Ç. është lëshuar leja e legalizimit nr. 6741, datë 27.05.2011, e nënshkruar nga E.P., punonjëse e ALUIZNI-it. Në përfundim, prokuroria ka çmuar se në nënshkrimin e bërë nga shtetasja E.P. nuk vërehen elemente të veprës penale të shpërdorimit të detyrës, të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal (*KP*), pasi leja e legalizimit është nxjerrë sipas procedurës së ndjekur nga të gjithë sektorët përgjegjës të ALUIZNI-it. Gjithashtu, gjatë hetimit ka rezultuar se shtetasi I.Ç. ka falsifikuar formularin e vetëdeklarimit të ndërtimit informal. Megjithatë, prokuroria ka arritur në përfundimin se nuk ishte e mundur të provohet se kur ishte falsifikuar dokumenti për të vlerësuar nëse do të ushtrohej ndjekja penale ndaj shtetasit I.Ç. Prokuroria ka vlerësuar që duke qenë se ndërtimi i paligjshëm ishte bërë në vitin 2009, për shkak të kalimit të afatit, nuk mund të ushtrohej ndjekja penale për akuzën e falsifikimit të dokumenteve. Për akuzën ndaj punonjësve të tjerë të ALUIZNI-it prokuroria ka vlerësuar se nuk provohet të kenë qenë punonjës të tjerë të përfshirë. Për rrjedhojë, prokuroria, me vendimin nr. 4171/2011, datë 09.04.2015, ka vendosur pushimin e procedimit penal.

4. Kërkuesi e ka kundërshtuar vendimin e pushimit penal në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila, me vendimin nr. 22 akti, datë 10.03.2016, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së kërkuesit. Ndaj vendimit ka paraqitur ankim kërkuesi.

5. Gjykata e Apelit Tiranë, pas zhvillimit të seancës në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 688, datë 16.03.2018, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 22 akti, datë 10.03.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe kthimin e çështjes për rigjykim po në atë gjykatë, me tjetër trup gjykues, duke arsyetuar se ajo nuk ka thirrur si palë në gjykim personat që kanë interes të ligjshëm, pra të kallëzuarit E.P. dhe I.Ç.

6. Ndërkohë, edhe shtetasi I.Ç. ka paraqitur kërkesë për kundërshtimin e vendimit të prokurorit për pushimin e procedimit penal. Për këtë kërkesë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 1187/14, datë 02.02.2018, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së kërkuesit I.Ç., si të pabazuar në ligj e në prova dhe lënien në fuqi të vendimit të pushimit të procedimit me nr. 4171/2011, datë 09.04.2015 të prokurorisë. Pas ankimit të shtetasit I.Ç., Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 725, datë 20.03.2018, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

7. Në lidhje me kërkesën e kërkuesit për kundërshtimin e vendimit të prokurorit për pushimin e procedimit penal, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në rigjykim, me vendimin nr. 2488 akti, datë 14.06.2018, ka vendosur rrëzimin e kërkesës. Ndaj vendimit ka paraqitur ankim kërkuesi dhe shtetasi I.Ç. Gjykata e Apelit Tiranë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 2136, datë 10.10.2018, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 2488 akti, datë 14.06.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Pas rekursit të ushtruar nga kërkuesi, në datën 20.12.2008, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2024-748, datë 23.04.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit.

8. Kërkuesi në datën 14.08.2024 (data e shërbimit postar) i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit. Në lidhje me afatin për shqyrtimin paraprak të çështjes, të përcaktuar në nenin 47, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, bazuar në nenet 15, pika 2 dhe 21, pika 1, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, në këtë afat nuk llogaritet periudha e lejes vjetore, sipas nenit 18, pika 1, shkronja “b”, të po këtij ligji.

## II

### **Pretendimet e kërkuesit**

9. ***Kërkuesi***, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar *e drejta për proces të rregullt ligjor* në drejtim të:

- 9.1. *Së drejtës për t'u njoftuar dhe dëgjuar*, pasi Gjykata e Apelit Tiranë nuk e ka njoftuar përbërjen e trupit gjykues, duke kryer shkelje të rëndë procedurale. Gjykata e Apelit Tiranë, duke e zhvilluar seancën në dhomën e këshillimit, ka privuar kërkuuesin nga mundësia për të paraqitur kërkesë për përjashtimin e trupit gjykues.
- 9.2. *Parimit të paanshmërisë*, pasi gjatë gjykimit në Gjykatën e Apelit Tiranë pjesë e trupit gjykues ka qenë gjyqtari G.L., i cili e ka shqyrtuar më parë një ankim të shtetasit I.Ç., ku palë ka qenë edhe kërkuesi, duke shprehur mendimin e tij. Pretendimi është parashtruar edhe në rekurs, por Gjykata e Lartë nuk i ka dhënë përgjigje.
- 9.3. *Parimit të barazisë së armëve*, pasi Gjykata e Apelit Tiranë e ka vendosur kërkuuesin në pozita të pafavorshme dhe të pabarabarta kundrejt palës tjetër, prokurorisë, argumentet e së cilës kanë marrë përparësi.
- 9.4. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi Gjykata e Apelit Tiranë nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të kërkuesisit. Vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë është i paargumentuar, i pambështetur në prova shkresore, i paqartë, për rrjedhojë është i pambështetur në ligj. Standardi i arsytimit të vendimit është cenuar edhe nga Gjykata e Lartë, e cila nuk ka trajtuar dhe nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve kryesore të parashtruara në rekurs. Në vendim nuk rezulton të jetë pasqyruar fakti që ka paraqitur disa herë parashtrime me shkrim, ku ishin trajtuar në mënyrë të detajuar shkeljet ligjore dhe procedurale të gjykatave të faktit. Gjykata e Lartë nuk e ka studiuar dosjen dhe nuk ka bërë vlerësim objektiv, ligjor dhe korrekt të pretendimeve. Gjykata e Lartë ka gabuar në qëndrimin e saj, duke u shprehur se nuk legjitimohet, pasi nuk ishte person i dëmtuar, por kallëzues.
- 9.5. *Së drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm*, pasi çështja në Gjykatën e Lartë është regjistruar në vitin 2019 dhe është shqyrtuar në datën 23.04.2024, pra 5 vjet më vonë.

### III

#### Vlerësimi i Kolegjit

##### A. Për legjitimitimin e kërkuesisit

10. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1,

shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

11. Në lidhje me legjitimitimin *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, individi mund të drejtohet me kërkesë në këtë gjykatë për çështje kur në bazë të normave procedurale, ai ka qenë palë drejtpërdrejt në proces, si dhe plotëson kriterin “detyrimi për të justifikuar interesin”.

12. Në këtë kuptim, Kolegji thekson se, bazuar në jurisprudencën kushtetuese, kërkuesi duhet të provojë legjitimitetin e tij si në aspektin procedural, ashtu edhe në atë substancial. Kjo, sepse individi mund të bëjë kërkesë në Gjykatë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij të drejtpërdrejta, si dhe të provojë se në çfarë mënyre ai është cenuar në të drejtat e tij kushtetuese, pra se është viktimë e një shkeljeje dhe se pasojat nga masa/akti i kundërshtuar janë të drejtpërdrejta dhe reale për të (*shih vendimet nr. 17, datë 13.03.2024; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Në çështjen konkrete, Kolegji vëren se procesi penal është vënë në lëvizje bazuar në kallëzimin penal të kërkuetit ndaj disa punonjësve të ALUIZNI-it, duke i akuzuar për veprën penale të shpërdorimit të detyrës, pasi, sipas tij, kishin dhënë lejen e legalizimit ndaj shtetasit I.Ç., fqinj me kërkuetin, në kundërshtim me ligjin. Gjykata e shkallës së parë ka vendosur rrezimin e kërkesës së kërkuetit, vendim i cili është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë dhe Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit.

14. Kolegji çmon të evidentojë se referuar ligjit procedural penal dhe vendimit unifikues nr. 2, datë 20.06.2013 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, kërkueti ka qenë në cilësinë e kallëzuesit dhe jo të personit të dëmtuar nga vepra penale. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se kërkueti nuk ka argumentuar dhe provuar cenimin e drejtpërdrejtë dhe real të interesit të tij nga vendimi objekt kundërshtimi i kësaj kërkesë. Nisur nga kjo, Kolegji vlerëson se kërkueti nuk legjitimohet *ratione personae*, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, për të vënë në lëvizje gjykimin kushtetues.

15. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

**PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

**V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.